



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

VARIANTI A

E shtunë, 2 qershor 2012

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

**Shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, seksioni dygjuhësh
(kurrikula e vjetër)**

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**, 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë.

Në të tri pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11a
Pikët											
Kërkesa	11b	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21
Pikët											
Kërkesa	22a	22b	23a	23b	24	25a	25b	25c	25d		
Pikët											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I

GJERGJ ELEZ ALIJA

Sa ka nisun dita me zbardhë majet,
n'fushë t'mejdanit trimat konkan dalë,
keq me fjalë shoshojnë po e rrekin:
“A prej vorrit Gjergj, ti konke çue?
Pse me m'qitë, bre burrë, në këtë fushë
t'mejdanit?”

Sa bukur trimi i ka përgjigjë Balozit:
“Të lumtë goja, Baloz, mirë po thue!
qe, nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit,
pak pa mrrijtë Baloz, ti m'ke dredhë:
m'ke lypë motrën para se mejdanin,
m'ke lypë berrat, para se çobanin,
e jam dredhë n'kët log për me t'kallxue
se ne t'parët' një kanun na kanë lanë:
armt' me dhanë përpara e mandej gjanë,
kurrë Balozit motrën mos me ia dhanë,
për pa u pre n'at' fushën e mejdanit!
Por shtrëngohu, Baloz, se të ka ardhë dita,
se ktu i thonë- o Gjergj Elez Alija!”
E i kanë ba dy gjokat tym për tym!
E në topuz Balozit e ka shënue,
në dy gjunjt' gjoku Gjergjit te i ka ra,
përmbi krye topuzi i ka fjurue;
dymbëdhjetë pash n'lëndinë u ngul topuzi,
dymbëdhjetë pash përpetë, si re, u çue
pluhni!
At'herë Gjergjit rendi te i ka ardhë,
Sa mirë trimi n'topuz qi ka dredhë,
lik përmbet Balozit te i ka ra.
A'trandë fusha kur u rrzue Balozit!
Mejherë trimi shpatën ma ka nxjerrun,
kryet me neje trupit ia ka damun,
zhag për kambësh trupin e ka ngrehun,
me gjithë at' në një pus e ka mbytn.
Të tanë lumin gjaku ka trazue;

për tri vjet krejt vendin e ka qelbun.
Qat'herë trimi a' nisë me dredhë tu shpija
dhe shokt'të gjith m'i ka bashkue:
“Po ndigjoni, more shokt'e mij:
falë u kofshin sarajet e mija,
falë u kofshin tanë paret e mija,
e u qoftë falë krejt malli e gjaja e shpisë,
amanet motra e Gjergj Elez Alisë!”
Edhe shtatit trimi i paska dhanun,
motërzezën grykas kesh me u marrun,
të dy zemrat priherë po janë ndalun,
vlla e motër dekun paskan ramun!
Kurrkujt shpirti ma mirë s'i ka dalun!
Gjamë të madhe shokët qi kanë ba,
Po ia çilin një vorr bukur t'gjanë,
vlla e motër grykas për me i zanë.
E i muranë t'bukur e kanë mbarue,
vlla e motër kurrë mos me u harrue.
E i bli t'bukur m'ia vendojnë te kryet,
zogu i verës gjithmonë me pushue.

Kur ka nisun mali me u dushkue,
a ndalë qyqja n'muranë t'vorrit t'ri!
Ka gjetë blinin të tanë degash tha;
ka flurue përmbi' i saraj të zi,
ka gjetë kulmin të tanë shembë përdhe.
M'nji prezor si m'paska hypë,
ka përbe shtegtarin kah po shkon:
“Amanet, more shtegtari i malit,
n'qofsh tuj kndue ksajt, kangën me e pushue
n'qofsh tuj qa ksajt, gjamin për me e zanë!
Kah kërkova gjithkund bjeshkë e m'bjeshkë,
kah verova gjithkund vrri e n'vrri,
kah mjerova gjithkund shpi e n'shpi,
kurrkund s'ndesha n'Gjergj Elez Ali!”

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. Toni me të cilin Baloz i drejtohet Gjergjit në vargjet e mëposhtme shpreh: **1 pikë**
A prej vorrit Gjergj, ti konke çue?
Pse me m'qitë, bre burrë, në kët fushë t'mejdanit?
- A) ironi;
 B) nervozizëm;
 C) keqardhje;
 D) seriozitet.
2. Në vargun: “*Pse me m'qitë, bre burrë, në kët fushë t'mejdanit?*”, shprehja *fush t'mejdanit* ka kuptimin: **1 pikë**
- A) sheshi i fshatit;
 B) sheshi i luftimit;
 C) luginë mes malesh;
 D) zona në kufi mes dy vendeve.
3. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur figura e hiperbolës? **1 pikë**
- A) në dy gjunjat' gjoku Gjergjit te i ka ra
 B) zhag për kambësh trupin e ka ngrehun
 C) sa mirë trimi n'topuz qi ka dredhë
 D) a'trandë fusha kur u rrzue Baloz
4. Në krijimtarinë popullore merr kuptim simbolik: **1 pikë**
- A) ndeshja e burrave me topuz.
 B) përdorimi i numrit nëntë.
 C) vajtimi i trimit të rënë nga shokët e tij.
 D) martirizimi i motrës për vëllanë.
5. Folja është përdorur në mënyrën dëshirore në vargun: **1 pikë**
- A) falë u kofshin sarajet e mija
 B) të lumtë goja, Baloz
 C) kurrkund s'ndesha n'Gjergj Elez Ali
 D) po ndigjoni, more shokt'e mij
6. Kjo këngë është shkruar me varg: **1 pikë**
- A) 9- rrokësh;
 B) 10- rrokësh;
 C) 11- rrokësh;
 D) 12 –rrokësh.
7. Në amanetin që Gjergji u lë shokëve të tij në prag të vdekjes shqetësohet për: **1 pikë**
- A) ruajtjen e shtëpisë nga shkatërrimi.
 B) mirëqenien e tyre.
 C) nderin dhe mirëqenien e motrës.
 D) vazhdimësinë e veprës së vet.

8. Cila është arsyeja që Gjergji dhe Balozë debatojnë me njëri-tjetrin përpara dyluftimit? **1 pikë**
- _____
- _____
9. Ç'loj fjale është për nga ndërtimi fjala *motërzeza*? Si është formuar ajo? **2 pikë**
- lloji: _____ formimi: _____
10. Ç'përfaqëson qyqja në këtë këngë dhe ç'ndjesi përcjell ajo te lexuesi? **2 pikë**
- _____
- _____
- 11.
- a) Atmosfera në fund të kësaj kënge ngrihet mbi një kontrast të fortë. Cili është ai? **1 pikë**
- _____
- _____
- b) Cilat janë të paktën tri detajet që shfrytëzon rapsodi popullor në funksion të këtij qëllimi?
Ç'efekt shprehësie krijojnë ato? **4 pikë**
- detajet: _____
- efekti i shprehësisë: _____
- _____
12. Zbuloni në fragment dy momente zakonore shqiptare të nderimit që i bëhen të vdekurit. **2 pikë**
- _____
- _____
13. Ç'efekt tingullor përftohet në vargjet e fundit të këngës? Cili është mjete stilistik që e krijon atë? **2 pikë**
- _____
- _____
14. Në këtë këngë vërejmë elemente të ekzistencës së kulteve të caktuara, që paraqesin veçori të vjetra etnopsikologjike të popullit tonë. Gjeni dy kulte të tilla, duke i ilustruar me shembuj nga vargjet. **2 pikë**
- _____
- _____

PJESA II**Viktor Hygo*****Katedralja e Parisit (fragment)***

Një qerre, të cilën e tërhiqte një kalë i fortë i racës normade dhe që ishte e rrethuar prej kalorësish me livre ngjyrë vjollcë me kryqe të bardha në kraharor, arriti te sheshi dhe nga ana e rrugës Sen-Pier-o Bëf. Policët i hapnin asaj udhën, duke e goditur turmën me shkopinj. Përbri qerres ecnin kaluar disa nëpunës të gjyqit dhe të policisë, të cilët mund t'i dalloje lehtë, ngaqë ishin veshur me rroba të zeza dhe qëndronin të ngathët mbi kuaj.

Në atë qerre të kobshme kishte ndenjur një vajzë me duar të lidhura prapa shpinës; ndodhej vetëm, pa prift. Ajo ishte e veshur me këmishë; flokët e saj të gjatë e të zinj (sipas zakonisht të atëhershëm ato priteshin vetëm rrëzë trikëmbëshit) i binin të shpërndarë mbi supet gjysmë të zbuluar dhe mbi kraharor.

Përmes këtyre tufave flokësh valëvitëse, të zeza dhe të ndritshme si pendë korbi, dukej një litar i trashë, i ashpër dhe i përhimët, që gërvishte supet e njoma dhe që vërtitej rreth qafës së hijshme të asaj vajze të mjerë, si një krimb i dheut rreth një luleje. Nën atë litar shndriste një hajmali e vogël, e stolitur me rruaza të blerta, të cilën dukej se asaj ia kishin lënë, ngaqë njeriut të dënuar me vdekje nuk ia kundërshtojnë më dëshirën. Spektatorët që kishin dalë në dritaret mund të shihnin në fund të qerres këmbët e saj të zbuluara, të cilat ajo, nga turpi, mendohej t'i fshihte nën vete. Pranë saj ishte një dhi e vogël, e lidhur dhe ajo me tërkuzë. Vajza e mbante me dhëmbë këmishën, që i binte nga supet.

- Pa shikoni, kushëri i bukur, -i tha befaz kapitenit Flër-de-Lisi, - qenka ajo cigania e fëlliqur me dhinë!

Ajo iu kthye Febysit, që ia kishte ngulur sytë qerres dhe ishte zbehur shumë.

- Ç'cigane me dhi? - pyeti ai duke iu marrë goja.

- Qysh! -tha Flër-de-Lisi. - A nuk ju kujtohet?...

Febysi ia preu fjalën.

- Unë nuk di ç'doni të thoni.

Ai u mat të kthehej në dhomë. Por Flër-de-Lisi, së cilës iu zgjua përsëri ndjenja e xhelozisë, që i ishte ngjallur pak muaj më parë po prej kësaj ciganeje, i hodhi atij një vështrim të mprehtë dhe dyshues. Në këtë çast asaj iu kujtua disi turbull se kishte dëgjuar që në procesin gjyqësor të asaj magjistareje ishte përzier edhe një kapiten.

- Ç'keni kështu? -e pyeti ajo Febysin. -Apo mos u turbulluat që e patë atë grua.

Febysi u mundua të qeshte:

- Unë? Aspak! E pse do të turbullohesha.

- Atëherë, qëndroni këtu, -tha ajo me ton urdhërues. - Rrini të shikojmë deri në fund. I gjori kapiten u detyrua të rrinte. Ajo që e qetësonte pak ishte se e dënuara e mjerë nuk i ngrinte sytë nga fundi i qerres. Ishte padyshim Esmeralda. Ndonëse e katandisur në atë shkallë të fundit të turp-it e të fatkeqësisë, ajo ishte prapë e bukur, sytë e saj të mëdhenj e të zinj dukeshin edhe më të mëdhenj nga faqet e thelluara; profili i saj i zbehtë ishte i kulluar. Ajo i shëmbëllente Esmeraldës së mëparshme, ashtu siç i shëmbëllente një madonë e Maziçios një madone të Rafaelos: më e ligsh, më e brishtë, më e hequr.

Nga ana tjetër, gjithçka te ajo, po të mund të shprehemi kështu, e kishte humbur drejtpeshimin; gjithçka ishte e topitur, me përjashtim të ndjenjës së turp-it: aq shumë ishte dërrmuar nga dëshpërimi, aq fort ishte mpirë nga shtangimi. Trupi i saj hidhej sa majtas-djathtas në çdo lëkundje të qerres, si ndonjë send i thyer ose i vdekur. Vështrimi i saj ishte i vrenjtur dhe i çakërritur. Në sytë dukeshin ende lot, por ishin lot të palëvizur, të ngrirë.

Për pyetjet nga 15 deri në 20 rrethoni alternativën e saktë.

- 15.** Epitetet e shumta që gjenden në fragment zbulojnë: **1 pikë**
- A) sjelljen e turmës ndaj Esmeraldës.
 B) gjendjen fizike dhe shpirtërore të Esmeraldës.
 C) marrëdhënien e Esmeraldës me Febysin.
 D) portretin fizik të Febysit.
- 16.** Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur antonimia kontekstuale? **1 pikë**
- A) i bukur – e fëlliqur;
 B) i thyer – i vdekur;
 C) i ngrirë – palëvizur;
 D) i vrenjtur- i çakërritur.
- 17.** Situata që përshkruhet në këtë fragment është: **1 pikë**
- A) absurde;
 B) tragjike;
 C) komike;
 D) e jashtëzakonshme.
- 18.** Ndjesia që ka Flër-de-Lisi kundrejt Esmeraldës është: **1 pikë**
- A) bezdi;
 B) neveri;
 C) keqardhje;
 D) indiferencë.
- 19.** Në cilën prej alternativave të mëposhtme gjuha e përdorur nga autori bëhet më emocionale dhe figurative? **1 pikë**
- A) Vajza e mbante me dhëmbë këmishën, që i binte nga supet.
 B) Por Flër-de-Lisi i hodhi atij një vështrim të mprehtë dhe dyshues.
 C) Nga ana tjetër, gjithçka te ajo, e kishte humbur drejtpeshimin.
 D) Përmes këtyre tufave flokësh valëvitëse, të zeza dhe të ndritshme si pendë korbi, dukej një litar i trashë, i ashpër dhe i përhimët.
- 20.** Kur autori thotë: “...gjithçka ishte e topitur, me përjashtim të ndjenjës së turpit”, ai nënkupton se gjithçka ishte: **1 pikë**
- A) e qetë;
 B) e mpirë;
 C) e turbullt;
 D) e papërmbajtur.

21. Përshkruani gjendjen e Esmeraldës në këtë fragment. Çfarë mendoni se mund ta ketë shkaktuar atë?

3 pikë

22.

a) Nga ajo çfarë lexoni në këtë fragment, a mendoni se Febysi dhe Esmeralda kanë qenë të lidhur më parë? Zbuloni dy momente në këtë pjesë që mbështesin mendimin tuaj.

2 pikë

b) Cila është ndjenja më e fortë që e përshkon Esmeraldën në këtë moment? Pse?

2 pikë

23.

a) Hygoi, si shkrimtar romantik, operon në vepër mbi bazën e kontrasteve të fuqishme. Identifikoni një të tillë në këtë fragment dhe shpjegoni efektin e kësaj kundërvënieje.

2 pikë

b) Zbuloni një detaj në këtë fragment, që na lë të besojmë se ngjarjet e këtij romani zhvillohen në mesjetë.

1 pikë

24. Çfarë ua tërheq më shumë vëmendjen si lexues: mënyra si Hygoi përshkruan gjendjen fizike apo shpirtërore të Esmeraldës? Argumentoni mendimin tuaj edhe me ilustrime nga fragmenti.

3 pikë

25. Romani “Katedralja e Parisit” ka shërbyer edhe si subjekt filmi. Midis të lexuarit të kësaj veprë dhe filmit, cilin do të preferonit? Argumentoni mendimin tuaj në formën e një eseje. **8 pikë**

Shtjellimi i idesë (25a)	Organizimi dhe struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d)	Totali
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë